



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 310/2015

Datë: 10 nëntor 2015

Në bazë të nenit 6 paragrafët: 6.2, 6.3 dhe 6.5 të Rregullorës për Zgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës (nr.02/2015), në mbledhjen e mbajtur me datë 10 nëntor 2015, nxori këtë:

**UDHËZIM PËR MËNYRËN E SIGURIMIT TË PËRFAQËSIMIT SHUMË ETNIK
DHE GJINOR NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS**

1. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) garanton përbërjen shumë etnike dhe gjinore në përbërjen e tij në bazë të Ligjit Nr.05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillit Prokurorial të Kosovës (GZ,nr.17,30 qershor 2015) dhe Rregullores për Zgjedhjen e anëtarëve të KPK-së Nr. 02/2015
2. KPK duhet të ketë së paku tre (3) anëtare të gjinisë femërore dhe së paku një (1) anëtar nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.
3. Pas përfundimit të procesit të votimit, Komisioni Zgjedhor i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KZ KPK),do të konstatojë nëse me këtë votim është siguruar përfaqësimi gjinor dhe etnik.
4. Nëse KZ KPK konstaton se një përfaqim i tillë nuk është arritur, atëherë KPK do të zbatojë rregullën sipas së cilës kandidatët femra që kanë përqindje më të madhe të votave, në proporcion me numrin e përgjithshëm të prokurorëve në atë prokurori, zgjedhën me përparësi anëtare të KPK-së.
5. Në rast se të nominuarit kanë vota të njëjta ose përqindje të njëjtë atëherë zgjedhja do të bëhet me short.
6. (KZ KPK) pasi të sigurojë që në KPK është plotësuar përfaqësimi gjinor dhe etnik shqyrëton rezultatët për anëtarët e tjerë.
7. KZ KPK do të njoftojë KPK për procesin zgjedhor.
8. Ky udhëzim është pjesë e Rregullores për Zgjedhjen e anëtarëve të KPK-së Nr. 02/2015.

 Aleksandër Lumezi
Kryetar Këshillit Prokurorial

